



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1649/4 Prot.

Tiranë, më 27/11/2019

**V E N D I M**

**Nr. 175., Datë 27 / 11 / 2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.143 Regj., datë 06.11.2019, të V. Q, kundër Bashkisë së Dropullit, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, V. Q shprehet se nga data 01.02.2014-31.12.2018, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Në muajin Shkurt 2019, ankuesja citon se ka filluar punë si Përgjegjëse e Kulturës pranë Bashkisë Dropull dhe se gjatë ushtrimit të detyrave të saj ka qenë korrekte dhe nuk ka marrë asnjë masë disiplinore, përkundrazi ka qenë shumë e vlerësuar për punën e saj. Që prej vitit 2017 është anëtare e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim si dhe Sekretare e Përgjithshme e LSI për Bashkinë Dropull.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Ankuesja provon bindjet e saj politike, nëpërmjet Kartës së Anëtarësisë në partinë politike “Lëvizja Socialiste për Integrim” (LSI), me nr.17779.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në ankesën e saj pranë KMD-së, ankuesja parashtron se: *“Në muajin Qershor 2019 u zhvilluan zgjedhjet për Organet e Vetëqeverisjes Vendore. Kryetari i mëparshëm i Bashkisë Dropull, z.A.D ka qenë përfaqësues i Partisë Demokratike, i cili tashmë u zëvendësua nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste, z.Dh.T. Me të marrë detyrën, Kryetari aktual ka filluar haptazi diskriminimet për shkak të bindjeve politike. Për shkak të bindjeve të mija politike, por edhe të lidhjeve familjare që kam me z.Vangjel Tavo, Bashkia Dropull ka nxjerrë vendimin për largimin tim nga puna, me motivacionin se nuk kam realizuar detyrat dhe kam munguar në punë më shumë se 7 shtatë ditë. Një fakt i tillë nuk është i vërtetë pasi nga mjeku specialist D.D kam marrë rekomandimin për regjim shtrati, pasi kam qenë sëmurë. Lidhur me këtë gjë kam lajmëruar Burimet njerëzore pranë Bashkisë Dropull, por ata nuk e kanë marrë në konsideratë këtë fakt. Bashkia Dropull ka ndërmarrë veprimë të tilla diskriminuese për largime nga puna për shkak të bindjeve politike, edhe ndaj punonjësve të tjerë që nuk kanë bindje të njëjta me ato të Kryetarit të Bashkisë”*.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të saj për shkak të bindjeve politike, nga ana e punëdhënësit dhe rikthimin në vendin e punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.1649/3 prot., datë 13.11.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Bashkisë Dropull, lidhur me pretendimin e ankueses.
- Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 19.11.2019, ankuesja ka dërguar nëpërmjet e-mailit Kërkesë-Padinë e saj kundër Bashkisë Dropull, e cila është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, me datë 15.11.2019.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Mbështetur në kopjen e Kërkesë-Padisë<sup>4</sup> së subjektit ankues, rezulton se pretendimin e saj për diskriminim nga ana e punëdhënësit e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Gjatë arsyetimit të kërkesë padisë së bërë nga ankuesja pranë Gjykatës e Shkallës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në faqen 3 (tre) të saj, citohet se: *“Nga mënyra se si janë bërë njoftimet e njëpasnjëshme, menjëherë sa ka filluar punë (kryetari i ri i Bashkisë) ka patur si qëllim, vetëm largimin tim nga puna, pasi unë i përakisja bindjeve të ndryshme politike nga të Kryetarit aktual të Bashkisë Dropull, duke qenë se jam anëtare e LSI. Pra, arsyeja e vetme e ndërprerjes së kontratës time të punës është vetëm për bindjet e mija politike dhe jo për shkaqet e pasqyruara prej të paditurit në njoftimet e bëra prej tij, apo në vendimin objekt kundërshtimi”.*

Ankuesja ka ngritur pretendimin se është shkelur dhe LMD, duke cituar konkretisht nenin 146, të Kodit të Punës, dhe respektivisht të pikës 1/c) të tij, ku parashikohet: *“Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme, kur: ...shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi...”*

Bazuar në sa më sipër, V. Q, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka pretenduar trajtimin diskriminues nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve politike, duke cituar respektivisht, në faqen 6 të saj se: *“...veprimet e palës tjetër-të paditurit- të paligjshme apo të kryera në shkelje të parimit të mirëbesimit si dhe në diskriminim e paditëses për shkak të bindjeve të saj politike”.*

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të*

<sup>4</sup> Kërkesë Padi e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më datë 15.11.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr.143 Regj., datë 06.11.2019, të V. Q, kundër Bashkisë Dropull.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 36 të “Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 90, pika 3 e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 4, të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën e hetimit të ankesës nr.143 Regj., datë 06.11.2019, të V. Q, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Bindjet politike